

FJALA JONË



KA VLERË

NE DHE DEMOKRACIA

ERION (13), BREROR (13), SUELA (13), ALISA (13), ANDRA (13), JON (13), DORANT (13)


Të gjithë jemi të barabartë në demokraci

Pas përfundimit të kësaj punëtorie, ne mësuam shumë gjëra. Së pari, ne filluam me një aktivitet i cili lidhej me temën. Pastaj, vazhduam me ndarjen e pozitave për përgatitjen e artikullit, dhe kjo u zhvillua në mënyrë demokratike.

Më pas, i mblodhëm të gjitha mendimet rreth demokracisë dhe qytetarisë aktive, që përfshinin përgjegjësitë dhe të drejtat e çdo qytetari të cilat janë: e drejta për votë, e drejta për fjalën e lirë, e drejta për punë, e drejta për arsim, e drejta për të pasur familje dhe shumë e shumë të drejta të tjera. Ne si qytetarë aktiv duhet të kryejmë obligimet dhe përgjegjësitë tona në mënyrë që vendi ynë të ecë çdo ditë e më shumë.



Të lumtur në demokraci



E drejta e punës



Shprehja e lirë e mendimit



Të jesh aktiv në komunitet



Përgjegjësia e qytetarit

NDARJA E PUSHTETIT NË DEMOKRACI

OLT KRASNIQI (13), DIOLA (13), OLT KONDIROLLI (13), ARGJENTINA (13), AULON (13), NART (12)



Institucionet më të rëndësishme të Kosovës

Ndarja e pushtetit përfaqëson qeverisjen e popullit. Pushteti ndahet në tri pjesë e ato janë: Pushteti Legjislativ, Gjyqësor dhe Pushteti Ekzekutiv. Pushteti Legjislativ (Kuvendi) përbëhet prej deputetëve dhe Kryetarit të Kuvendit. Në sallën e Kuvendit, mbahen seancat plenare ku deputetët iu drejtohen qytetarëve. Brenda në sallën e Kuvendit gjenden ulëset e deputetëve, hapësira për gazetarë (media) dhe një pjesë për vizitorët. Deputetët të cilët e përbëjnë Kuvendin propozojnë ligjet, i votojnë ato dhe i miratojnë ose nuk i miratojnë. Kuvendi miraton edhe buxhetin e vendit. Gjykata është organ i drejtësisë. Pushteti Gjyqësor është pjesa tjetër e pushtetit të një vendi, e cila

ushrohet nga gjykata.

Gjykata, sikurse edhe Kuvendi dhe Qeveria funksionon në mënyrë të pavarur. Gjykata i trajton qytetarët në mënyrë të barabartë. Gjykata përbëhet prej avokatëve, gjykatësve, prokurorëve.

Pushteti Ekzekutiv ushtrohet nga Qeverisë. Qeveria përbëhet prej Kryeministrit, zëvendëskryeministrit dhe ministrave.

Qeveria i zbaton ligjet që miratohen në Kuvend. Qeveria përbëhet nga partia politike e cila i ka fituar zgjedhjet. Qeveria ka për detyrë të siguroj një ambient të përshtatshëm për qytetarët. Nga e gjithë kjo, kuptuam se pushtetet edhe pse janë të ndara ato punojnë, bashkëveprojnë me njëra-tjetrën dhe i ndihmojnë njëra-tjetrës për zhvillimin e vendit.



Të bashkuar për një të ardhme

VOTO EDHE TI

BIANT (13), ERIKA (13), ARNIS (13), ROZAFI (13), DION (13), OLTA (13)

Në botë ekzistojnë njerëz të racave, gjinive, e kulturave të ndryshme dhe sigurisht këta njerëz kanë mendime të ndryshme. Por, mendimet duhen të grumbullohen në mënyrë që të zgjedhet i/e duhuri/a.

Zgjedhjet janë element kryesor i demokracisë. Populli zgjedh përmes votës e cila është e fshehtë dhe nuk duhet të imponohemi nga dikush tjetër. Megjithatë, që nga kohët e hershme, njerëzit e kanë njohur sistemin e votimit. Por, shumica e tyre nuk kanë pasur të drejtën që të votojnë. Disa vende, ende ballafaqohen me këto probleme. Në shekullin e XVII-të vetëm aristokratët kanë pasur të drejtën e votës. E më vonë, u vendos që të gjithë burrat të votonin, por sërish gratë nuk ishin të përfshira. Sot, me përparime të mëdha, në vendin tonë lejohet të votojnë dy gjinitë, por me kusht që të jenë mbi 18 vjeç. Me zhvillimin tonë të gjithë kemi të drejtë të fusim nga një copë letre në kutinë misterioze të votimit...



E ardhmja e qytetit



Voto lirshëm



PUSHTETI LEGJISLATIV - KUVENDI

ARTI (13), DARIS (13), DEA (13), GRAMOZ (14), LENDEA (13), LEORITA (13), LEKA (13)



Kuvendi, zëri i popullit

Vendet demokratike kanë edhe institucione demokratike. Një ndër këto institucione është edhe Kuvendi. Kuvendi si Pushtet Legjislativ, miraton dhe aprovon ligje për shtetin ose Republikën e Kosovës.

Kuvendi i Kosovës është organi i parë më i lartë legjislativ, dhe si i tillë ka disa funksione: përfaqësimin e popullit, ku këtu nënkuptojmë që deputetët e përfaqësojnë votën e qytetarëve në Kuvend, mbikëqyrjen e Qeverisë, në mënyrë që ekzekutivi t'iu përgjigjet detyrave të tij që ka si institucion, si dhe miratimin e ligjeve. Si përfaqësues të popullit janë gjithsej 120 deputetë, 100 prej tyre janë shqiptar, ndërsa 20 të tjerët janë nga komunitetet jo shumicë. Ky numër i deputetëve përbëhet nga pozita dhe opozita, por dihet se pozita ka më shumë deputetë sesa opozita.

Në Kuvend, si institucion demokratik që është, të


gjitha mbledhjet janë të drejtpërdrejta, dhe mund të ndiqen direkt në televizionin publik të Kosovës. Në seancat plenare mund të jenë të pranishme: shoqëria civile, mediat të ndryshme, etj. E tërë kjo bëhet me miratimin e Kuvendit.

Kuvendi, po ashtu ka disa komisione, ku detyra e secilit komision është që të jetë përgjegjës për fushën e caktuar, p.sh. Komisioni për Arsim është përgjegjës për fushën e arsimit.

Seancat në Kuvend janë të transmetuara në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe, në gjuhën angleze dhe në gjuhën turke.

Pra, si temë që kemi shtjelluar në grupin e vogël, ne kishim Kuvendin dhe u njoftuam nga afër me detyrat dhe përgjegjësitë që Kuvend si institucion demokratik ka. Kuvendi është organi kryesor politik për funksionimin e një shteti demokratik.





IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Faik Konica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë